



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

VENDIM

Nr. 98, datë 01.12.2020

“PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR.85 DATË 13.11.2020 PËR PEZULLIMIN E PROCEDURËS QË LIDHET ME KANDIDIMIN E ZOTIT INDRIT SHTUPI PËR INSPEKTOR JO MAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NË DATËN 07.02.2020”.

KOMITETI I EMËRIMIT EDHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE i përbërë nga :

**Artur Metani - Kryetar
Mirela Kapo - Anëtare
Marsela Pepi- Anëtare**

Asistuar nga sekretare Adela Skora,

në mbledhjen e datës 01.12.2020, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

INSPEKTOR JO MAGJISTRAT

Zoti Indrit SHTUPI

OBJEKTI:

Shqyrtimi i kandidimit të zotit Indrit SHTUPI, në vendin vakant për Inspektor jo magjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020.

KOMITETI PASI :

U njoh me kërkesën e shtetasit Indrit Shtupi, u njoh me vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme nr.768/184 datë 26.11.2020 si edhe bisedoi çështjen,

1

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 59 e vijues të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisimit të kushteve dhe të kritereve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistrat për pozicionin e inspektorit", nenit 66 të Kodit të Procedurave administrative, me vendimin nr.85 datë 13.11.2020 vendosi:

1. Pezullimin e procedurave që lidhet me kandidimin e zotit Indrit Shtupi, në vendin vakant për Inspektor Jo Magjistrat, i shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020.

Ky vendim i është njoftuar kandidatit Indrit Shtupi si edhe ky vendim është publikuar në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në pjesën e përcaktuar për "Rekrutim Inspektor Jo magjistrat", ëëë.ild.al.

2. Nëpërmjet kërkesës së datës 23.11.2020 shtetasi Indrit Shtupi ka kërkuar "Revokimin e aktit administrativ nr. 85, datë 03.11.2020 "për pezullimin e procedurës që lidhet me kandidimin e Z. Indrit Shtupi, në vendin vakant për inspektor Jo magjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020" dhe lejimin e kandidimit të Indrit Shtupi për vendet vakante për inspektor jo magjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020".

3. Konkretisht shtetasi Indrit Shtupi shprehet se : "Më datë 20.11.2020 kam marrë njoftimin nga ana juaj nëpërmjet adresës elektronike për Vendimin nr. 85, datë 03.11.2020 "Për pezullimin e procedurës që lidhet me kandidimin e z. Indrit Shtupi në vendin vakant për Inspektor Jo Magjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, unë kandidati Indrit SHTUPI kam dorëzuar në afat formularin e vetë deklaratimit sipas ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të cilin, juve Inspektori i Lartë i Drejtësisë ia keni përcjellë për verifikim dhe kompetence sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 768/180 prot., datë 19.10.2020, ka dërguar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë informacion lidhur me kandidatin Indrit SHTUPI, duke ardhur në përfundimet se:

Për subjektin Indrit Shtupi për shkak të deklaratimeve të tij ne formularin e vetë deklaratimit, lidhur me hetimet për përdorim dokumentacioni të rremë në Greqi, Prokuroria e Përgjithshme i është drejtuar me kërkesë për informacion autoriteteve të drejtësisë së

republikës së Greqisë. Si rrjedhojë në zbatim të detyrimeve të nenit 8 dhe kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, Prokuroria e Përgjithshme do të disponojë me "Vendim për miratimin e rezultateve të verifikimit" për këtë subjekt, në momentin që do të marrë një përgjigje zyrtare nga autoritetet greke të drejtësisë, përgjigje e cila nisur nga eksperiencia e mëparshme mund të vonoje shumë në kohë, ndoshta disa muaj. Për këtë arsye Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve nën kryesimin tuaj ka marrë Vendimin nr. 85, datë 03.11.2020 "Për pezullimin e procedurës që lidhet me kandidimin e z. Indrit Shtupi në vendin vakant për Inspektor Jo Magjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020". Ky vendim i ILD "Për pezullimin e procedurës që lidhet me kandidimin tim në vendin vakant për Inspektor Jo Magjistrat" cenon të drejtën time për të vazhduar kandidimin për vendet vakante për Inspektor Jo Magjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020. Unë kam përmbushur të gjitha detyrimet e kërkuara dhe të parashikuara nga ligji.....Në lidhje me shkresën nr. 768/180 prot., datë 19.10.2020 të Prokurorisë së Përgjithshme që ka dërguar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 'informacion lidhur me kandidatin Indrit SHTUPI', ku unë kam deklaruar në formularin e vetë deklaramit, që jam hetuar për përdorim dokumentacioni të rremë në Greqi, Prokuroria e Përgjithshme i është drejtuar me kërkesë për informacion autoriteteve të drejtësisë së republikës së Greqisë.

.....Unë si kandidat për vendin vakant për Inspektor Jo Magjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020 në lidhje me deklaramin që kam bërë në formularin e vetë deklaramit kam barrën e provës që të provoj që nuk jam dënuar me vendim të formës së prerë për rastin e deklaruar në formularin e vetë deklaramit. Vendimi i pafajësisë që disponoj, nr. 30.628/2009, i formës së prerë të Gjykatës të Shkallës së Parë së Athinës provon këtë gjë.....Vendimi im i pafajësisë nr. 30.628/2009 i formës së prerë i Gjykatës të Shkallës së Parë së Athinës për rastin e deklaruar në formularin e vetë deklaramit dhe që i është dërguar Prokurorisë së Përgjithshme për verifikim dhe kompetencë, vërteton që unë e përmbush kushtin që parashikohet nga shkronja "d" e nenit 209, pika 6, të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati "ç) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një veprë penale;" dhe për këtë arsye kërkoj të revokohet Vendimi nr. 85, datë 03.11.2020 "Për pezullimin e procedurës që lidhet me kandidimin e z. Indrit Shtupi në vendin vakant për Inspektor Jo Magjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020" dhe të lejohet kandidimi im për vendet vakante për Inspektor Jo Magjistrat, shpallur nga ju si Inspektor i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020."

4. Kërkesës së mësipërme, të transmetuar nga ana e shtetasit Indrit Shtupi nëpërmjet email-it të tij "indritshtupi@yahoo.com", shtetasit Shtupi i ka bashkëlidhur edhe një kopje të vendimit "të Gjykatës së Shkallës së Parë Athinë", të paraqitur nëpërmjet "Vërtetimit të njësisë me origjinalin", me nr.rep.3152 datë 23.11.2020.

5. Gjithashtu nëpërmjet emailit të mësipërm kandidatit Indrit Shtupi në datën 25.11.2020 i ka bashkëlidhur kopjen e skanuar të Vendimit nr. 30.628/2009 i Gjykatës të Shkallës së Parë Athinë legalizuar me vulë Apostile.

6. Me vendimin nr. 768/184 datë 26.11.2020¹, Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur:

- Nuk rezultoi të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile të padeklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara, me përjashtim të ndryshimit të kryer në datë 25.06.1980, të përbërësit të gjendjes civile, rubrikës së emrit të nënës nga “Myhribane” në “Myriban”.
- Nuk rezultoi i dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e veprës penale, nga autoriteti gjyqësor shqiptar.
- Nuk rezultoi i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar për një ceshtje penale të pazgjydhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Nuk rezultoi të ketë qenë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk rezulton të ketë qenë e siguruar me ndonjë masë shtrënguese të sigurisë personale.

6.1 Vlen për tu shtuar, në zbatim të nenit 78 “*Bashkëpunimit gjatë hetimit administrativ*”, Prokuroria e Përgjithshme në faqen 3 të këtij vendimi, konkretisht në pikën 5.8.1 shton se Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur të pranojë dokumentin zyrtar të dorëzuar nga ana e shtetasit Indrit Shtupi.

7. Me vendimin nr. 85 datë 13.11.2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendosi:

“Pezullimin e procedurave që lidhet me kandidimin e zotit Indrit Shtupi, në vendin vakant për Inspektor Jo Magjistrat, i shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020”.

7.1 Ky vendim është marë nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme sipas ligjit dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, ku Komiteti me vendim marrjen e datës 13.11.2020 ka arritur në përfundimin se lidhur me kandidaturën e zotit Indrit SHTUPI, nga ana e organit të ngarkuar me ligj, nuk ofrohen të dhëna nëse kandidati e përmbush kushtin e parashikuar nga shkronja “d” e nenit 209, pika 6, të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati “ç) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale;”

8. Referuar vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “*Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit*”, në pjesën që parashikohet “*Procedura të vecanta për verifikimin e kandidatëve jomagjistratë*”, në gërmën B, vendimi trajton “*Verifikimin e integritetit të kandidatit jomagjistratë*”.

¹ Protokolluar pranë I.L.D-së më datë 01.12.2020 me nr. Prot. 718/28

8.1. Konkretisht në pikën 59 e në vazhdim , vendimi parashikon se .. “*Inspektori e përcjell menjëherë formularin e vetëdeklarimit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të plotësuar nga kandidati jomagjistrat, në Prokurorinë e Përgjithshme....Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimet sipas ligjit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga paraqitja e vetëdeklarimit pranë atij institucioni.*”

9. Pra në këtë këndvështrim, nga aktet e administruara në dosjen e kandidatit rezulton se Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ushtruar kompetencat e veta ligjore dhe është Prokuroria e Përgjithshme organi i ngarkuar me ligj për të kryer verifikimet sipas ligjit.

9.1 Referuar vendimit nr.768/184 datë 26.11.2020², Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur:

- Nuk rezultoi të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile të padeklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara, me përjashtim të ndryshimit të kryer në datë 25.06.1980, të përbërësit të gjendjes civile, rubrikës së emrit të nënës nga “Myhribane” në “Myriban”.
- Nuk rezultoi i dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e veprës penale, nga autoriteti gjyqësor shqiptar.
- Nuk rezultoi i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar për një ceshtje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Nuk rezultoi të ketë qenë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk rezulton të ketë qenë e siguruar me ndonjë masë shtrënguese të sigurisë personale.

10. Nisur nga sa është ekspozuar më sipër, në vijim të arsyetimit se ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes si edhe bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektor jo magjistrat, Komiteti vjen në përfundimin se kushti i pezullimit ka rënë dhe se duhet të procedohet me **revokimin e vendimit të pezullimit** që lidhet me kandidimin e zotit Indrit Shtupi për vendin vakant për Inspektor Jo magjistrat në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020.

11. Gjithashtu me anë të këtij vendimi Komitetit ka vendosur vijimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës së Zotit Indrit Shtupi;

² Protokolluar pranë I.L.D-së më datë 01.12.2020 me nr. Prot. 718/28

12. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit, vjen në përfundimin se duhet të procedohet me vijimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës së Zotit Indrit Shtupi, në vendin vakant për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 27 e vijues të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", vendimit nr. 768/184 datë 26.11.2020³ të, Prokurorisë së Përgjithshme, Inspektori i Lartë i Drejtësisë:

VENDOSI:

1. Revokimin e vendimit të pezullimit nr. 85 datë 13.11.2020;
2. Vijimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës së Zotit INDRIT SHTUPI, për vendin vakant për Inspektor Jo Magjistrat, Inspektor i Lartë i Drejtësisë, i shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020.
3. Ky vendim i njoftohet kandidatit INDRIT SHTUPI.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në pjesën e përcaktuar për "Rekrutim Inspektor Jo magjistrat".

ANËTARE
Mirela KAPO



ANËTARE
Marsela PEPI



KRYETARI
Artur Metani



³ Protokolluar pranë I.L.D-së më datë 01.12.2020 me nr. Prot. 718/28
6